



## THIRRJE

për ekspert/e për përpilimin e dokumentit për politika (policy brief)

Shoqata për Mundësi të Barabarta "Rrjeti Stella" në kuadër të projektit "Avokim për fuqizimin ekonomik të grave: qasje e barabartë në mundësi për pavarësi financiare" si pjesë e programit bilateral për subgrantim të organizatave të shoqërisë civile të grave, zbatuar nga Rrjeti Kombëtar Kundër Dhunës mbi Gratë dhe Dhunën në Familje me mbështetje financiare nga [Kvinna till Kvinna Foundation](#) shpall **thirrje për ekspert/e për përpilimin e një përmbledhje të politikave (policy brief) mbi mundësitë ekonomike të grave dhe vajzave në vend përmes burimeve financiare në dispozicion për fuqizimin ekonomik.**

### Përshkrimi i aktivitetit

Qëllimi i projektit është të krijohen strategji afatgjata për përmirësimin e gjendjes së grave dhe vajzave gjatë punësimit dhe lehtësimin e sfidave me të cilat përballen në vendet e punës, si dhe paraqitjen e mundësive dhe udhëzimeve të barabarta për shfrytëzimin e politikave ekzistuese dhe përmirësimin e atyre aktuale.

Fokusi i dokumentit strategjik për politika (policy brief) duhet të jetë në sfidat ekonomike të grave dhe vajzave, (nënat e vetme, gratë fermere, gratë që i kanë mbijetuar dhunës dhe gra të tjera me qasje të reduktuar në mundësi), analiza e planeve dhe masave për vetëpunësim dhe punësim, punësim të subvencionuar, mundësi për shfrytëzimin e lehtësimeve financiare, qasje në fonde për fillimin e një biznesi, plane operacionale për stratup-e, si dhe rekomandime për punëdhënësit për një hapje më të madhe ndaj sfidave reale të grave.

### Detyrat e punës dhe rezultatet e pritura

Për të përmbushur angazhimin, eksperti/ja do të duhet të kryejë detyrat e mëposhtme të punës:

- Të përgatisë dokument të shkurtë të politikave (rreth 3-4000 fjalë) në gjuhën **maqedonase ose shqipe** që do të përmbajë masat e disponueshme për nënat e vetme, gratë fermere, gratë që i kanë mbijetuar dhunës dhe gratë e tjera me qasje të reduktuar në mundësitë për vetëpunësim në treg, punësim të subvencionuar, qasje në fonde për fillimin e një biznesi dhe lehtësimet financiare në vend dhe plane operacionale për startup-e, si një lloj plotësimi të ["DORACAKUT për vajzat dhe gratë me informacione të nevojshme mbi mundësitë e disponueshme për mbështetje të vetëpunësimit ose fillimin e biznesit personal"](#) nga "Rrjeti Stella";
- Në dokument duhet të formulohen rekomandime që janë të zbatueshme dhe të realizueshme për institucionet shtetërore me qëllim të përmirësimit të politikave për vetëpunësim, punësim të subvencionuar dhe mbajtjes së biznesit personal, si dhe rekomandime për punëdhënësit për një hapje më të madhe ndaj sfidave reale të grave.



- Të japë mendim ekspert me konkluzione përfundimtare nga dokumenti për politika;
- Të bashkëpunojë me ekipin e projektit të "Rrjetit Stella" në përgatitjen e këtij dokumenti në përputhje me afatin e propozuar, në koordinim me ekipin e projektit.

Përmes listimit të synuar të rekomandimeve për institucionet shtetërore për lehtësimin e procesit të aplikimit për mbështetje, por edhe theksimin e hendekut gjinor në sektorin privat, dokumenti strategjik, përmes një fushate avokimi, do të paraqitet në hapësirën publike, por edhe te grupet e synuara përfundimtare. Dokumenti për politika do të përdoret nga "Rjeti Stella" për të avokuar për gratë në Maqedoninë e Veriut në drejtim të paraqitjes së mundësive ekonomike dhe fuqizimit të tyre financiar.

### **Korniza kohore dhe pagesa**

Angazhimi i punës zgjat 30 ditë, duke filluar nga data 15.04.2024, ndërsa dokumenti i politikave duhet të përgatitet dhe finalizohet përfshirë datën 15.05.2024.

Kompensimi financiar i parashikuar për përgatitjen e dokumentit për politika është në shumën prej 49.500 denarë bruto.

### **Profili dhe kualifikimet e nevojshme**

Eksperti/ja për përgatitjen e policy brief duhet të përmbushë kualifikimet e mëposhtme:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë në fushën përkatëse për këtë thirrje;
- Të njohë mundësitë ekonomike të tregut dhe masat për vetëpunësim, disponueshmërinë e masave për financim dhe lehtësim për fillimin e biznesit personal ose startup-it;
- Përvojë në përpilimin e analizave, raporteve, doracakëve, udhëzimeve dhe ngjashëm.;
- Aftësi të zhvilluara kërkimore dhe analitike;
- Njohje e avancuar dhe komunikim në gjuhën angleze.

### **Mënyra e aplikimit, dokumentet e kërkuara dhe personi për kontakt**

Nëse jeni të interesuar të aplikoni për përgatitjen e dokumentit për politika (policy brief) dhe nëse i përmbushni kushtet e thirrjes, duhet të paraqisni një CV/biografi të shkurtë dhe metodologji, si dhe 5 analiza, raporte ose doracakë që keni përgatitur.

Dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në versionin elektronik në [info@stella.mk](mailto:info@stella.mk) me shënim **Апликација за експерт/ка за изработка на документ за политики за економско зајакнување на жените и девојките**. Afati i fundit për aplikim është deri më 10.04.2024, ora 23.59.

Personi për kontakt në lidhje me thirrjen publike të publikuar është Marta Stevkovska, koordinatore e projektit, email: [tanevska.marta@gmail.com](mailto:tanevska.marta@gmail.com), tel: +389 75 733 094.